



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 99, datë 11.2.2026

P Ë R

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.681,
DATË 2.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MËNYRËN E KRIJIMIT, TË ORGANIZIMIT
E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
(AKR)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Turizmit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.681, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e krijimit, të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, të kreut III, bëhen këto shtesa:

- a) Në shkronjën “d”, pas fjalëve “... për të rinjtë ...” shtohen “... bashkive dhe grupeve joformale rinore;”;
- b) Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1”, me këtë përmbajtje:

“d/1) Zbaton programin e talenteve rinore, publikon dhe promovon thirrjet për aplikim, menaxhon procesin e përzgjedhjes dhe akordon mbështetjen financiare për të rinjtë, përfitues në program;”.

- c) Në shkronjën “ë”, pas fjalëve “... jep informacion ndaj të rinjve ...” shtohen “... dhe grupeve joformale rinore ...”;

- ç) Në shkronjën “f”, pas fjalëve “... organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, ...” shtohen “... dhe grupet joformale rinore ...”;
- d) Në shkronjën “i”, pas fjalëve “... vendase apo të huaj ...” shtohen “... individ dhe grup joformal rinor ...”;
- dh) Në shkronjën “j”, pas fjalëve “... monitoron zbatimin e projekteve ...” shtohen “... dhe programeve për të rinjtë ...”;
- e) Në shkronjën “o”, pas fjalëve “... organizatat për të rinjtë ...” shtohen “... dhe grupet joformale rinore ...”;
- ë) Pas shkronjës “o” shtohen shkronjat “o/1” dhe “o/2”, me këtë përmbajtje:

“o/1) Mbulon shpenzimet e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR);

o/2) Mbulon shpenzimet për trajtimin ushqimor dhe trajnimin e të rinjve, që përfshihen në periudhën 3-mujore të praktikës, në kuadër të thirrjes vjetore të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës (PKPP);”.

2. Në pikën 7, të kreut 3, emërtimi “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” zëvendësohet me “Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit”.

II. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT**

BLENDI GONXHIJA

NR.PROT. 839/1
DATË 11. 2 .2026

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

